



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 46 datë 25.09.2025

PËR

MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË KUSHTEVE TË LEJES SË ZHVILLIMIT PËR
OBJEKTIN: "KOMPLEKS TURISTIK, REZIDENCIAL, HOTELERI DHE SHËRBIME 1,
2 DHE 3 KATE MBI TOKË DHE 1, 2 DHE 3 KATE NËNTOKË", ME VENDNDODHJE
NË PERIVOLO, GJILEK, DHËRMI, BASHKIA HIMARË

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit" i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues "Orion" sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin e rishikimit të kushteve të lejes së zhvillimit për objektin: "Kompleks turistik, rezidencial, hoteleri dhe shërbime 1, 2 dhe 3 kate mbi tokë dhe 1, 2 dhe 3 kate nëntokë", me vendndodhje në Perivolo, Gjilek, Dhërmi, Bashkia Himarë, me subjekt zhvillues shoqërinë "Orion" sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave si dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë bashkëlidhur Vendimit Nr. 23, datë 31.07.2024, zëvendësohen me Hartën e Planvendosjes së Strukturave si dhe Dokumentin e Rregullores së Veçantë bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyjnë në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI R. MA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT

BLENDI GONXHJA



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 31 / 12 / 2025